



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 1911/1 Prot.

Tiranë, më 21.3. 2023

UDHËZIM

Nr. 9, datë 21.3. 2023

PËR

**DISA SHITESA NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 05.07.2022 “PËR VLERËSIMIN E  
NXËNËSVE NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4, të nenit 48, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

- I. Në udhëzimin nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”, pas nenit 9, të shtohen neni 9/1 dhe neni 9/2 me përmbajtje, si më poshtë:

**Neni 9/1**

**“Vlerësimi i nxënësve në shkollat e orientuara të drejtimit artistik”**

1. Për të gjithë lëndët e kulturës së përgjithshme, vlerësimi i nxënësve realizohet në përputhje me përcaktimet në udhëzimin nr. 17, datë 05.07.2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.
2. Për të gjitha lëndët e kurrikulës artistike, vlerësimi realizohet në dy periudha, si më poshtë:
  - a) Periudha e parë: Shtator - Janar
  - b) Periudha e dytë: Shkurt – Qershor.
3. Dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit të nxënësve për lëndët e kurrikulës artistike sipas periudhave për shkollat e orientuara të drejtimit artistik në degët “Muzikë” dhe “Koreografi”, të jetë si më poshtë:

Periudha e parë		Periudha e dytë		Vlerësimi vjetor		Nota përfundimtare
Vlerësim i vazhduar teknik	Detyrë përmbledhëse (Saxho)	Vlerësim i vazhduar teknik	Detyrë përmbledhëse (Saxho)	Vlerësim i vazhduar teknik	Detyrë përmbledhëse (Saxho)	

4. Vlerësimi përfundimtar për lëndët e kurrikulës artistike kryhet në përfundim të vitit shkollor me notë.
5. Procedura për përlogaritjen e notës përfundimtare vjetore është:
  - a) Nota vjetore e vlerësimit të vazhduar teknik përcaktohet bazuar në dy notat e vlerësimit të vazhduar teknik të periudhave, duke e vlerësuar në mënyrë progresive.
  - b) Nota vjetore e detyrës përmbledhëse (saxho) përcaktohet bazuar në dy notat e detyrës përmbledhëse (saxho) të periudhave, duke e vlerësuar në mënyrë progresive.
  - c) Nota përfundimtare përcaktohet bazuar në notën vjetore të vlerësimit të vazhduar teknik dhe notën vjetore të detyrës përmbledhëse (saxho).
6. Dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit të të nxënit për lëndët e kurrikulës artistike, sipas periudhave për shkollat e orientuara të drejtimit artistik, në degën “Art figurativ”, është si në tabelën më poshtë:

Periudha e parë	Periudha e dytë	Nota përfundimtare
Vlerësim i vazhduar teorik dhe praktik	Vlerësim i vazhduar teorik dhe praktik	

7. Vlerësimi përfundimtar për lëndët e kurrikulës artistike kryhet në përfundim të vitit shkollor me notë.
8. Nota përfundimtare përcaktohet bazuar në dy notat e vlerësimit të vazhduar teorik dhe praktik të periudhave, duke e vlerësuar në mënyrë progresive.
9. Praktika profesionale për shkollat e orientuara të drejtimit artistik në degët “Muzikë”, “Koreografi” dhe “Art figurativ” vlerësohet në përfundim të zhvillimit të saj me një notë përfundimtare.

## Neni 9/2

### “Vlerësimi i nxënësve në shkollat e orientuara të drejtimit sportiv”

1. Për të gjitha lëndët e kulturës së përgjithshme, vlerësimi i nxënësve realizohet në përputhje me përcaktimet në udhëzimin nr. 17, datë 05.07.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.
2. Praktika profesionale për shkollat e orientuara të drejtimit sportiv vlerësohet në përfundim të zhvillimit të saj me një notë përfundimtare.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

**MINISTËR**

**EVIS KUSHI**

